




BUXHETIMI GJINOR SI NJË MJET TRANSFORMUES I BUXHETIT PËR INSTITUCIONET KOMUNALE

“Buxhetimi gjinor si një mjet transformues i buxhetit për institucionet komunale”

Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i Transparencës dhe Llogaridhënies për Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi,” i përkrahur nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), në kuadër të Rrjetit të Mbikëqyrjes së Buxhetimit Gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë (RrMBGJ), i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Projekti u zbatua në periudhën 1 shtator 2023 – 31 gusht 2024 nga organizata e grave “Mitrovica Women Association for Human Rights.”

Përmbajtja është përgjegjësi e organizatës MWAHR dhe nuk reflekton pikëpamjet e RrGK, RrMBGj, ADA dhe Sida.



FALENDERIME

Monitorimi i BPGJ në Mitrovicën e Jugut nuk do të ishte i mundshëm pa përkrahjen dhe mbështetjen financiare nga RrMBGj dhe RrGK, në kuadër të projektit "Fuqizimi i Transparencës dhe Llogaridhënies për Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi", i cili mbështetet nga ADA dhe SIDA

Programi RrMBGj synon forcimin e rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) si palë të interesuara që kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës dhe përmirësimin e menaxhimit të parave publike duke monitoruar dhe vlerësuar ndikimin e politikave dhe buxheteve gjinore në barazinë gjinore.

Falenderim i veçantë për kreun e Mitrovicës së Jugut, kryetarin e komunës, z. Bedri Hamza, si dhe nënkryetarin, z. Arian Tahiri, për përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të projektit, si dhe për forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit si dokument zyrtar.

Një kontribut të çmuar në realizimin e studimit kanë dhënë drejtorët e drejtorive, si dhe zyrtarët administrativë të drejtorive të monitoruara.

Falenderojmë drejtorët dhe zyrtarët komunalë të Mitrovicës së Jugut:

- Arian Tahiri – nënkryetar i komunës së Mitrovicës
- Igballe Islami – drejtoreshë e financave
- Drita Ibrahimimi – drejtoreshë e mirëqenies sociale
- Fahri Shaban – drejtor i shëndetësisë
- Ferdi Kadriu – drejtor i bujqësisë
- Gëzim Stavileci – drejtor i administratës
- Valdete Idrizi – drejtoreshë e rinisë, kulturës dhe sportit
- Fahri Jashari – drejtor i drejtorisë Rinisë, Kulturës dhe Sportit (DRKS)
- Besmir Salihu – drejtor i Zyrës për Punësim në Mitrovicë
- Hysnije Mikullovcit – zyrtare në drejtorinë e bujqësisë
- Albana Fejza – zyrtare në drejtorinë e shëndetësisë



- Berat Jashari – shef në drejtorinë e shëndetësisë
- Nexhat Rushiti – zyrtar në Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS)
- Arber Hajra – shef në DKRS – kulturë
- Lule Veseli – shefe në DKRS – rini
- Nazmi Rama – shef në DKRS – sport

Një falenderim gjithashtu për pjesëmarrësit/et e takimeve (353 pjesëmarrës/e), bashkëpunëtorët, gratë e shoqërisë civile dhe stafin e MWAHR, që mundësuan zbatimin e suksesshëm të projektit.



OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË PROJEKTIT:

- Rritja e pjesëmarrjes së grave në takimet e “dëgjimeve publike” që organizon komuna për të marrë rekomandime për përpilimin e qarkores buxhetore vjetore.
- Rritja e mundësisë për ta bërë qeverinë komunale të ndihet e përgjegjshme për angazhimet e saj ndaj barazisë gjinore.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E MONITORIMIT

Qëllimi i këtij monitorimi është analizimi i zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në komunën e Mitrovicës dhe përkushtimi i zyrtarëve përkatës që miratojnë vendime për shpërndarjen e drejtë dhe të përgjegjshme të buxhetit komunal për gra dhe burra.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT, POR EDHE TË KËTIJ MONITORIMI, JANË:

- Identifikimi dhe analizimi i shpërndarjes së buxhetit për sa i përket ndarjes së shërbimeve të ndihmës sociale, subvencioneve, granteve dhe bursave, si dhe alokimeve buxhetore për shërbimet e caktuara.
- Analizimi i numrit të grave dhe burrave që kanë përfituar nga një program apo projekt i caktuar brenda departamentit apo divizionit komunal të Mitrovicës.
- Sigurimi që sistemet e menaxhimit të financave publike të përfshijnë proceset e buxhetimit gjinor.
- Hartimi i rekomandimeve kyçe për hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe buxheteve nga pikëpamja gjinore për sektorët e sipërpërmendur, si dhe për procesin e buxhetimit në përgjithësi.
- Vetëdijësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve/grave në takimet konsultative buxhetore që organizohen nga komuna.

Ky raport do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës së shpenzimit të buxhetit komunal.



PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS PËR BUXHETIMIN E PËRGJEGJSHËM GJINOR

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)¹ është një strategji që fokusohet në integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin dhe buxhetimin e qeverisë që synon të përfshijë një perspektivë se si të përmirësohet barazia midis grave dhe burrave, duke u bazuar në një analizë gjinore në çdo fazë të planifikimit, programimit dhe ekzekutimit të buxheteve qeveritare. Kështu, që nuk duhet parë si një buxhet shtesë, por si një mënyrë për të bërë planifikim dhe buxhetim më të mirë, bazuar në evidenca më specifike në lidhje me burrat dhe gratë si përfitues të politikave dhe buxheteve.

Komuna e Mitrovicës së Jugut zbaton buxhetimin gjinor duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës (LBGJ), ku BPGJ përkufizohet si *“zbatimi i integritetit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve².”* Integrimi gjinor përkufizohet si *“përfshirje e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, të planifikimit, miratimit, zbatimit, përcjelljes dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave ose programeve dhe buxheteve, në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, duke pasur parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta mes meshkujve dhe femrave³.”* Në këtë kuadër si masë përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, duhet të përfshihet edhe *“çaktimi i burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave⁴.”*

Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë⁵, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, për të ofruar udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të

¹ RrGK, [Udhërrëfyes Praktik, Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Lokal](#); shiko: [Udhërrëfyes Praktik Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Qendror](#)

² Kuvendi I Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore](#), Neni 3, paragrafi. 1.17

³ Po aty, Neni 3, paragrafi. 1.16

⁴ Po aty, Neni 5, paragrafi. 1.7

⁵ [Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#), Neni 20.



Kosovës dhe secila organizatë buxhetore është përgjegjëse që të përgatisë dhe t'i dorëzojë Ministrit, propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarje buxhetore.

Niveli Komunal

Me qarkoren buxhetore janë përcaktuar grantet qeveritare për financimin komunal për vitin 2025 dhe orientimet për vitet 2026-2027, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, qarkorja ka përcaktuar nivelin e të hyrave vetanake komunale për vitin fiskal 2025, si dhe parashikimet afatmesme për vitet 2026-2027.

Procesi i buxhetit komunal ka marrë parasysh këto aspekte:

- Buxhetimin në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimin e konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale; si dhe
- Përcaktimin e strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Edhe pse Qarkorja Buxhetore e përfshin në pikën 8 Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjikor (BPGJ), ajo nuk e ka trajtuar zbatimin e buxhetimit gjikor si pikë të veçantë në procesin e buxhetit komunal.



REZULTATET KRYESORE TË TAKIMEVE

Takime me gra dhe vajza (të rinjë) - Dëgjimet buxhetore:

Gjatë zbatimit të projektit janë organizuar gjashtë (6) takime me gra, vajza dhe të rinj. Qëllimi i këtyre takimeve ishte informimi i pjesëmarrësve mbi mekanizmat mbrojtës vendorë dhe ndërkombëtarë për gratë, shpjegimi i konceptit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ), dhe rritja e vetëdijes për pjesëmarrje në takimet me qytetarë – takime konsultative publike për projekt-buxhetin e komunës.

“pa pjesëmarrjen e grave në takime konsultative, e cila zakonisht është shumë e vogël, nevojat dhe kërkesat e tyre mbeshin pa u përfshi në qarkoren buxhetore vjetore të komunës.

Në mungesë të informatave për kërkesa të grave buxhetimi i përgjegjshëm gjinator nuk planifikohet dhe nuk realizohet në barabarsi”.

-Drejtoresha e drejtorisë për buxhet dhe financa

Komuna e Mitrovicës organizon çdo vit, gjatë muajve korrik dhe gusht, takime konsultative publike për projekt-buxhetin e komunës për vitin përkatës. Këto takime përmbushin obligimin ligjor të përcaktuar nga Qarkorja Buxhetore e vitit 2024.

Qarkoret Buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave kanë nxitur organizatat buxhetore, si në nivel qendror ashtu edhe lokal, që të integrojnë të dhënat buxhetore gjinore në Kornizat e tyre Afatmesme, si dhe të shtojnë përfshirjen gjinore në buxhetet e tyre vjetore.

Komuna është e angazhuar për të përfshirë burrat dhe gratë si partnerë të barabartë në planifikimet, programimet dhe buxhetimet qeveritare. Një buxhetim gjinor i mirëplanifikuar, që pasqyron nevojat e burrave dhe grave, mundëson zhvillim, rritje dhe prosperitet ekonomik të një komune.

Rekomandim për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrtaren për Barazi Gjinore
Për organizimin më të suksesshëm të “Takimit Konsultativ Publik për Projekt-Buxhetin e Komunës me Gra dhe Vajza,” rekomandohet që:

- Drejtorja për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore, të krijojë një partneritet të ngushtë me organizatat e grave, me qëllim koordinimin më të mirë të datës dhe orës së organizimit të takimit konsultativ. Ky bashkëpunim do të ndihmojë në sigurimin e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të grave dhe vajzave, duke u mundësuar që të shprehin nevojat dhe prioritetet e tyre në procesin buxhetor.



Takimi i parë me gra dhe vajza

Data: 10 tetor 2023

Pjesëmarrës: 23 gra (21 shqiptare, 1 boshnjake dhe 1 ashkallike)

Profile: Gra me profile dhe moshë të ndryshme.

Rekomandimet

- Ndarja e një linje buxhetore/fondi për projekte për pensionistë, për të mbështetur aktivitetet dhe iniciativat që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe angazhimin e tyre në aktivitete sociale dhe kulturore.
- Të ndahet një hapësirë, objekt ku pensionistët mund të takohen dhe kalojnë kohën, për t'u mundësuar atyre një ambient të përshtatshëm për aktivitete sociale dhe relaksim.
- Hapësira të posedojnë mini bibliotekë dhe materiale për argëtim, duke ofruar mundësi për zhvillim intelektual dhe pasurim të kohës së lirë.
- Për grupin e grave “Gratë e Mitrovicës lexojnë” të ndahet një hapësirë ku ato mund të takohen, lexojnë dhe komentojnë romanet, duke ofruar mundësi për zhvillim kulturor dhe forcimin e lidhjeve sociale mes grave.
- Qendra rinore dhe qendra sportive të posedojnë hapësira që aktualisht nuk përdoren dhe janë të boshatisura, duke i shfrytëzuar ato për aktivitete që mund të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit, siç janë takimet, leximet dhe diskutimet për librat, artin, dhe kulturën.

Takimi i dytë me gra dhe vajza

Data: 12 tetor 2023

Pjesëmarrës: 23 gra shqiptare (përfshirë 1 grua me aftësi të kufizuara).

Profile: Gra me profile dhe moshë të ndryshme.



Rekomandimet

- Të rritet buxheti për ndarjen e granteve për grupe të grave të shoqërisë civile, duke siguruar mbështetje më të madhe për iniciativat dhe projektet që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të grave dhe avancimin e barazisë gjinore.
- Të rritet shuma e grantit për përfitueset e granteve nga zyra për barazi gjinore, për t'u mundësuar grave të kenë burime më të mëdha për zhvillimin e projekteve që mbështesin barazinë gjinore dhe avancimin e të drejtave të grave.
- Në bashkëpunim me OJQ-të e grave, të organizohen trajnime për zyrtarët komunalë për 'mekanizmat mbrojtës nga dhuna, vendorë dhe ndërkombëtar', për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve në mbrojtjen dhe mbështetjen ndaj viktimave të dhunës.
- Hapja e një biznesi të rrobaqepësisë në Roma Mahallë, duke krijuar mundësi punësimi për gratë rome, të cilat hasin vështirësi për t'u punësuar në kompani të tjera të qytetit, duke kontribuar në përfshirjen e tyre në tregun e punës dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

Takimi i tretë me gra dhe vajza

Data: 11 qershor 2024

Pjesëmarrës: 28 gra shqiptare (19 nga fshatrat e komunës së Mitrovicës).

Profile: Gratë ndërmarrëse të angazhuara në prodhime artizanale, ushqime tradicionale, bletari, dhe shpezëtari.

Rekomandimet

- Vendosja e kiosqeve të premtuara nga komuna në një hapësirë të caktuar, për të ofruar mundësi për shitësit lokalë dhe për të rritur vizibilitetin e produkteve të zonës.
- Të përcaktohet vendi për organizimin e panairove – sheshi Adem Jashari, duke siguruar një hapësirë të përshtatshme për ekspozimin e produkteve të bizneset lokale dhe promovimin e iniciativave të grave dhe grupeve të tjera.
- Grante të vogla për kavanoza dhe tenxhere për prodhimin e turshive dhe ajvarit, për të mbështetur bizneset e vogla dhe iniciativat e gra, të cilat merrem me prodhimin dhe



përpunimin e ushqimeve tradicionale. Organizimi i vizitave studimore, për të mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe mësimin nga praktikat më të mira të zhvillimit të bizneseve në komunitetet e tjera.

- Transporti për ndërmarrjet që marrin pjesë në panairë në qytete të tjera të Kosovës, për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe promovimin e bizneseve të vogla dhe grupeve të grave në panairët jashtë komunës.
- Të rregullohet rruga "Kristalet" në Trepçë, për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të mundësuar një qarkullim më të sigurt dhe më efikas për banorët dhe bizneset në këtë zonë.

Takimi i katërt me gra dhe vajza

Data: 12 qershor 2024

Pjesëmarrës: 20 gra shqiptare

Profile: Gratë nga fusha e arsimit

Rekomandimet

- Bursa për vajzat rome/ashkalike që vijojnë mësimin në shkollat shqipe në Mitrovicën e Jugut, për të mbështetur çasjen e barabartë në arsim dhe për të inkurajuar vajzat të qëndrojnë në shkollë dhe të përfitojnë nga mundësitë e arsimimit.
- Mundësimi i regjistrimit të vajzave rome/ashkalike në shkollën e mesme të mjekësisë, duke ofruar mundësi edukimi dhe karriere për vajzat që i përkasin grupeve të marginalizuara.
- Stimulimi i vajzave për tu regjistruar në shkollën e mesme të teknikës përmes përkrahjes me bursa, për të promovuar sektorin e teknologjisë dhe inxhinierisë dhe për të rritur përfshirjen e vajzave në këto fusha të rëndësishme.
- Bursa për vajza nga viset rurale, për të mbështetur vajzat që vijnë nga familje me mundësi të kufizuara dhe për t'i inkurajuar ato të ndjekin arsim të mëtejshëm.
- Ndërtimi i konviktit për vajza nga viset rurale, për të ofruar një mundësi që ato të mund të regjistrohen dhe të ndjekin shkollimin në qytet, pa shqetësime për mungesën e strehimit.
- Angazhimi i mësimdhënësve mbështetës për nxënësit me ngecje fizike, për të siguruar një mësim dhe përkrahje të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke mundësuar



akses të barabartë në arsim.

- Të ndahet më shumë buxhet për mjete didaktike, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për t'u ofruar mësuesve dhe nxënësve mundësi të mira për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë e tyre.
- Emërimi i psikologëve në shkolla, për të ofruar mbështetje psikologjike për nxënësit dhe për të ndihmuar ata të përballen me sfidat emocionale dhe psikologjike që mund të hasin gjatë periudhës shkollore.

Takimi i pestë me gra, vajza, burra dhe djem

Data: 19 qershor 2024

Pjesëmarrës: 21 pjesëmarrës, 12 vajza (9 shqiptare dhe 3 ashklike) dhe 9 djem (8 shqiptar dhe një ashkali)

Rekomandimet

- Të rregullohet ndriçimi në lagjën “Adem Voca”, për të siguruar siguri dhe kushte më të mira jetese për banorët, veçanërisht gjatë natës.
- Në lagjen “Adem Voca” në ambullantë nuk ka mjekë të rregulltë, si dhe mungojnë barnat esenciale, që përbën një problem të madh për shëndetin e banorëve. Kjo kërkon një angazhim të menjëhershëm për të siguruar shërbime shëndetësore të plota.
- Të riaktivizohet zyra policore e cila është pa zyrtarë policor për një kohë të gjatë, për të siguruar një nivel më të lartë të sigurisë dhe rendit publik në këtë lagje.
- Drejtoria e RKS-së së bashku me të rinjtë të organizojnë trajnime programuese, për t'u mundësuar të rinjve aftësi profesionale dhe mundësi më të lehta punësimi.
- Ndërrimi i rregullores së bursave studentore, duke mundësuar që edhe studentët e vitit të parë të aplikojnë për mbështetje financiare, për të përmirësuar aksesin e të rinjve në arsim të lartë.
- Të organizohen sesione informuese në fshatra, ku të rinjtë do të luajnë rol aktiv në organizimin e këtyre aktiviteteve, duke rritur mundësitë për përfshirje dhe informacion për shërbime të ndryshme të disponueshme.



Takimi i gjashtë me gra, vajza, burra dhe djem

Data: 26 Qershor 2024

Pjesëmarrës: 30 pjesëmarrës gjithsej, përfshirë: 14 anëtarë nga Organizata “Së Bashku” (5 burra dhe 9 gra), nga të cilët 11 ishin me aftësi të kufizuara (5 burra dhe 6 gra). 3 vullnetarë dhe staf (2 gra dhe 1 burrë). 16 pjesëmarrës nga komuniteti (9 rome dhe 7 ashkalike).

Rekomandimet

- Të sigurohet transporti për anëtarët e organizatës “Së bashku”, persona me aftësi të kufizuara. Shumica e anëtarëve përdorin karroca dhe banojnë në zona të largëta nga qendra apo edhe në fshatra, prandaj është e nevojshme që transporti të sigurohet për t'u mundësuar atyre pjesëmarrje në aktivitete dhe shërbime.
- Të mundësohet qasja në katet e epërme të objektit të komunës për persona me nevoja të kufizuara. Sigurimi i mundësive për qasje të lehtë dhe të sigurtë në të gjitha ambientet e objektit është i domosdoshëm për integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara.
- Në objektin e komunës të vendosen banjo/tolete për persona me nevoja të kufizuara. Kjo do të mundësojë kushte më të mira dhe akses të lehtë për të gjithë qytetarët, pa përjashtuar ata me aftësi të kufizuara.
- Banjo/toaleta publike në qytet për persona me nevoja të kufizuara. Krijimi i kushteve për përdorim të lehtë dhe të aksesueshëm të banjove publike është i nevojshëm për t'i shërbyer të gjithëve.
- Të vendosen në rrugë vijat për të verbër dhe për karroca. Kjo do të përmirësojë lëvizshmërinë e personave me aftësi të kufizuara dhe të verbër, duke i mundësuar atyre të lëvizin pa pengesa.
- Në zyrën e shoqatës së të verbërve të rregullohet banjo/toaleti. Kyçja e ujit dhe shkallët hyrëse janë shumë të papërshtatshme për ata që kanë vështirësi në lëvizje, dhe duhet të riparohen për të garantuar kushte më të mira.
- Punësimi i personave me nevoja të kufizuara, jo vetëm si praktikantë për disa muaj, por në vende pune me kohë të pakufizuar. Ky hap do t'i mundësojë individëve me aftësi të



kufizuara të kenë mundësi më të qëndrueshme dhe të barabartë për punësim dhe zhvillim.

Vajzat e reja shprehën interesim për pjesëmarrjen në takimet me qytetarët dhe kishin kërkesa specifike që duhet të merren parasysh.

SESIONE INFORMUESE ME DREJTORËT E DREJTORIVE KOMUNALE

Janë realizuar shtatë (7) sesione informuese me drejtorët e drejtorive komunale: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Administratës Publike, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Zyra e Entit për Punësim.

Qëllimi i takimeve

Qëllimi i takimeve ishte që të pranishmit të informoheshin se drejtoritë zbatojnë buxhetimin gjinor, duke mbështetur gratë dhe burrat përmes subvencioneve, granteve, bursave studentore, si dhe duke sqaruar se si mbështeten gratë dhe burrat fermerë, cilat kritere zbatohen për mbështetjen e të sëmurëve (pacientëve), dhe sa mbështeten kategoritë më të ndjeshme të qytetarëve, përfshirë të pastrehët, viktimat e fatkeqësive natyrore, shoqatat e marginalizuara, të rinjtë, gratë dhe burrat sportistë, si dhe gratë dhe burrat nga fusha e kulturës. Gjithashtu, u diskutua se si ndihmohen të rinjtë përmes punësimit dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Takim informues me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të komunës së Mitrovicës së Jugut

Takimi u organizua më datë 23 nëntor 2023, në sallën e mediave të komunës së Mitrovicës së Jugut.

Në takim morën pjesë 20 pjesëmarrës/e, përfshirë: Drejtorin e Drejtorisë së BZHR, një zyrtarë të Drejtorisë së BZHR, një burrë dhe 17 gra ndërmarrëse (17 gra shqiptare, një grua ashkalike dhe 2 burra shqiptarë). Drejtori i Drejtorisë së BZHR, z. Ferdi Kadriu, iu drejtua grave duke i uruar për punën dhe bizneset që ato zhvillojnë, duke ndihmuar familjet e tyre dhe njëkohësisht biznesin vendor. Ai prezantoi raportin e subvencionimit të fermerëve gjatë vitit 2023 në rajonin e Mitrovicës së Jugut, duke theksuar se buxheti për këtë sektor është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara.



Kjo drejtori përballet me vështirësi në zbatimin e buxhetimit gjinor, pasi gratë, në krahasim me burrat, merren shumë më pak me bujqësi. Madje, edhe ato gra që e ushtrojnë këtë veprimtari si biznes apo si mbështetje për familjet e tyre, shpesh hasin vështirësi për të përfutur mbështetje, për shkak të mungesës së tokës bujqësore në emër të tyre. Në rajonin e Mitrovicës, vetëm 15% e bizneseve bujqësore udhëhiqen nga gratë, pasi pronarët e tokave bujqësore janë kryesisht burra.

“se po punojnë për të gjetur alternative për të rritur poenat shtese per gratë por edhe për të gjetur mënyra tjera për lirim nga disa dokumantcione që kërkohen për aplikime”

- Drejtori I drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Një rast specifik këtë vit ishte dhënia e mekanizmave bashkëngjitës për traktorë, ku kriteri kryesor ishte që bujku të kishte traktor në emrin e tij. Për këtë arsye, asnjë grua nuk ka aplikuar, pasi asnjëra prej tyre nuk kishte traktor si pronë në emrin e saj

Rekomandimet

- Të subvencionohen gratë që merren me bizneset e punimeve artizanale, pasi këto biznese asnjëherë nuk janë përkrahur nga komuna.
- Të përkrahen bizneset e grave në komunat veriore, sepse ato nuk marrin mbështetje as nga komunat veriore të rajonit të Mitrovicës.
- Të organizohen më shumë panaire, mundësisht çdo dy muaj.
- Të organizohen vizita studimore në rajon me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe marrjes së ideve të reja për zhvillimin e bizneseve.
- Të organizohen trajnime për veprimtaritë me të cilat merren gratë.



Tabela 1.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve⁶

Mbeshtetje bujqësore 01.01.-31.12.2023	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni vlerësues	
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali Euro	Gra	Burra	Gra	Burra
Përkrahje e sektorit të Perimtarisë-Subvencionimi i fermerëve me serra të tipit Tunel (2 dhe 5 ari) DBZHR	<u>2</u>	<u>8</u>	<u>10</u>	<u>2</u>	<u>6</u>	<u>8</u>			<u>42,900.00</u>	<u>12%</u>	<u>88%</u>	<u>2</u>	<u>1</u>
Përkrahje e sektorit të bujqësisë – Subvencionimi i fermereve me mekanizëm bujqësorë (motokultivatorë me paisje përcjellese Islamic Relief Kosova	8	110	118	5	80	85			130,368.00 DBZHR 182,515.20 Islamic Relief Kosova	<u>4%</u>	<u>96%</u>	1	2
Përkrahje e sektorit të bujqësisë - Subvencionimi i fermereve me mekanizëm bujqësorë (kositëse rrotative) Islamic Relief	1	10	11	1	6	7			/			1	2
Përkrahje e sektorit të bujqësisë - Subvencionimi i fermereve me mekanizëm bujqësorë (spërkatëse) Islamic Relief	0	14	14	/	4	4			/			1	2
Përkrahje e sektorit të bujqësisë - Subvencionimi i fermereve me mekanizëm bujqësorë (rrotofreza) Islamic Relief	0	26	26	0	16	16			/			1	2

⁶ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Të dhënat e tabelës tregojnë se ndarja e subvencioneve në sektorin e bujqësisë për vitin 2023 ka pasur një shpërndarje të dukshme të pabarabartë mes grave dhe burrave. Përkrahja për fermerët me serra të tipit Tunel (2 dhe 5 ari) është ndarë me 12% për gratë dhe 88% për burrat, duke treguar një përqindje të lartë për burrat në këtë sektor. Po ashtu, subvencionimi për mekanizmin bujqësor (motokultivatorë) ka pasur një ndarje të ngjashme, me 4% për gratë dhe 96% për burrat. Megjithatë, për sektorët si kositësja rrotative dhe spërkatësja, ndarja ka qenë më e balancuar, për shkak të një numri më të vogël të aplikantëve dhe përfituesve, ku grante janë dhënë vetëm në disa raste specifike. Kjo tregon se në përgjithësi, ende ekziston një ndarje joadekuate gjinore në bujqësi, ku burrat përfitojnë një pjesë të madhe të subvencioneve, ndërsa gratë mbeten të përfaqësuara më pak, sidomos në sektorët më të zhvilluar të bujqësisë si mekanizmat bujqësorë.



1.2 Tabela e përfituesve të subvencioneve⁷

Mbeshtetje bujqësore 01.01.-06, 2024	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni vlerësues		
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali Euro		Gra	Burra	Gra	Burra
Subvencionimi i fermereve me serra 100 m2 nga Islamic Relief	11	79	145	6	35	41							1	2
Fondi për bashkëfinancim të projekteve me IADK-në				/	11	11			39.000.00		0%	100%	1	2
Përkrahje e sektorit të Bletarisë – Subvencionimi i bletarëve me koshere bletësh 3 katëshe , DBZHR	8	47	55	8	42	50			22,746.00		26%	74%	2	1
Përkrahje e sektorit të bujqësisë - Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësorë (mbjellëse gruri, mbjellëse misri).DBZHR	0	18	18	/	15	15			62,043.00		0%	100%	2	1
Kompenzim i dëmeve për fermerë dhe ekonomi bujqësore nga DBZHR				2	24	26			6.690		22%	78%	2	1
Panairi për promovimin e produkteve bujqësore dhe artizanateve tradicionale		/		40	/	40			9,900.00		0%	100%	2	1
Numrin e trajnimve – sa gra dhe sa burra				/	/	/								

⁷ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Në periudhën Janar-Qershor .2024, tabela tregon një shpërndarje të pabarabartë të mbështetjes financiare për fermerët, me një preferencë të dukshme për burrat në disa sektorë të bujqësisë. Për subvencionimin e fermerëve me serra 100 m2 nga Islamic Relief, gratë përbëjnë vetëm 15% të përfituesve, ndërsa burrat dominonin me 85%. Po ashtu, për sektorin e bletarisë, përfituesit janë gjithashtu të ndarë në mënyrë të pabarabartë, me 26% të grave dhe 74% të burrave që përfituan subvencione për koshere bletësh. Përkrahja për fermerët me mekanizëm bujqësor ka pasur gjithashtu një ndarje të tillë, me 0% të grave dhe 100% të burrave që përfituan mbështetje për mbjellësit e grurit dhe misrit. Megjithatë, në disa aktivitete të tjera, si kompensimi i dëmeve dhe panairi për promovimin e produkteve bujqësore, ndarja është gjithashtu më e theksuar për burrat, me 78% të përfituesve burra dhe vetëm 22% gra. Kjo tregon se ende ka një pabarazi gjinore të theksuar në sektorin e bujqësisë, me gratë që mbeten të përfaqësuara më pak në shumicën e aktiviteteve mbështetëse.

Sipas të dhënave në tabelat më sipër, në këtë drejtori buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk mund të zbatohet dhe ka dallim të madh në mes përfituesve gra dhe burra diku 20% gra me 80% burra.

Tabela 1.3. Subvencionet për vitin 2020/2021⁸

Periudha	Programi/Subvencioni	Gratë (%)	Burrat (%)
2020/2021	Subvencionim me serra	17%	83%
2020/2021	Mbështetje në sektorin e pemtarisë (arra dhe lajth)	0%	100%

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë një ndarje të dukshme gjinore në shpërndarjen e subvencioneve për periudhën 2020/2021. Për subvencionimin me serra, vetëm 17% e përfituesve janë gra, ndërsa shumica prej 83% janë burra, duke treguar një mungesë të balancuar të përfshirjes gjinore në këtë sektor. Ndërkohë, për mbështetje në sektorin e pemtarisë, konkretisht për arra dhe lajth, të gjitha subvencionet (100%) janë për burra, duke theksuar një tjetër hendek të madh gjinor

⁸ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



dhe mungesë të mbështetjes për gratë në këtë industri specifike. Këto rezultate sugjerojnë nevojën për masa për të promovuar pjesëmarrjen dhe mbështetje të barabartë për gratë në këto sektorë.

Tabela 1.4. Subvencionet për vitin 2023/2024⁹

Periudha	Programi/Subvencioni	Gratë (%)	Burrat (%)
2023/2024	Subvencionim i sektorit të perimtarisë	12%	88%
2023/2024	Subvencionimi i bletarëve me koshere	26%	74%
2023/2024	Kompensim i dëmeve për fermerë dhe ekonomi bujqësore	22%	78%

Të dhënat e paraqitura për periudhën 2023/2024 tregojnë një prirje të vazhdueshme të pabarazisë gjinore në shpërndarjen e subvencioneve në sektorët e bujqësisë dhe të bletarisë. Për subvencionimin e sektorit të perimtarisë, vetëm 12% e përfituesve janë gra, ndërsa 88% janë burra, duke theksuar një dominim të burrave në këtë sektor. Po ashtu, për subvencionimin e bletarëve, gratë përbëjnë 26% të përfituesve, ndërsa burrat 74%, duke treguar se ka një përfshirje më të madhe të grave në këtë sektor, por ende shumë më pak se burrat. Kompensimi i dëmeve për fermerët dhe ekonomitë bujqësore ka një përfshirje më të madhe të grave, me 22%, krahasuar me 78% për burrat, por përsëri ndarja është e pasugjeruar. Këto rezultate tregojnë se gratë janë ende të pakicë në këto sektorë dhe ka nevojë për masa që të rrisin përfshirjen e tyre dhe të sigurojnë mundësi të barabarta në mbështetje financiare dhe subvencione

Rekomandimet

- Heqja e kriterëve për pronësinë dhe bashkë-pagimin për mikro-grantet: Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e qasjes në financim për gratë në zonat rurale, duke eliminuar barrierat që shpesh pengojnë gratë të aplikojnë për mbështetje financiare, veçanërisht ato që nuk kanë pasuri të regjistruar ose mundësi për të kontribuar me pagesa të tjera. Organizimi i

⁹ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



panaireve për gratë: Është e rëndësishme të krijohen mundësi që gratë të ekspozojnë dhe të shesin produktet e tyre lokale dhe artizanale.

- Organizimi i së paku dy panairove do t'i mundësojë grave të rrisin mundësitë e tregtimit të produkteve të tyre dhe të promovojnë iniciativat e tyre biznesore, duke kontribuar kështu në rritjen e pavarësisë ekonomike dhe përfshirjes së grave në zhvillimin ekonomik lokal.
- Rritja e pikëve afirmative për gratë në aplikimet për subvencione: Për të rritur përfshirjen e grave në përfitimin e subvencioneve bujqësore dhe për të ndihmuar në adresimin e pabarazive gjinore, është e rekomandueshme të rriten pikët afirmative për gratë në aplikimet për subvencione nga 10 në 30 pikë. Kjo do të krijonte mundësi më të barabarta dhe do të inkurajonte gratë të aplikojnë dhe të përfitojnë nga mbështetjet financiare që ofron Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Takimi informues me Drejtorinë e Administratës Publike të Komunës së Mitrovicës së Jugut

Takimi informues me Drejtorinë e Administratës Publike të Komunës së Mitrovicës së Jugut u zhvillua më 12 dhjetor 2023 dhe pati pjesëmarrës nga shoqëria civile, studentë, përfitues të bursave dhe granteve, dhe qytetarë. Takimi përshkroi mbështetje të drejtpërdrejtë nga njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Gjinore, duke ofruar subvencione për organizatat joqeveritare dhe bursa për studentët. Drejtori Gezim Stavileci theksoi se, megjithëse organizatat e grave dhe studentet femra përfitonin në numër më të madh, kjo ishte për shkak të përmbushjes së kriterëve të thirrjeve publike dhe jo për arsye gjinore. Zyrtari për të drejtat e njeriut, Fitim Rama, theksoi se komisionet nuk kanë përmbushur kriteret e barazisë gjinore dhe se ka mungesë të interesit nga gratë për të aplikuar si anëtare të komisioneve.

Rekomandimet

- Drejtoria të angazhohet në ndryshimin e rregullores për subvencionimin me bursa për studentët, në mënyrë që të përfshihen studentët e vitit të parë, të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe për t'u lehtësuar fillimi i studimeve.
- Rritja e shumës së përkrahjes për organizatat, përcaktimi i një mbështetjeje më të



madhe për organizatat do të kontribuonte në zhvillimin e aktiviteteve më cilësore, duke i mundësuar atyre të realizojnë projekte më të mira dhe me ndikim të madh në fushën e të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore. Kjo do të ndihmonte gjithashtu në forcimin e kapaciteteve të organizatave për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të promovuar barazinë.



2.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve¹⁰

Mbështetje 01.01.-31.12.2023													
Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve		
	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali Euro	OJQ Gra	Burra	Gra	Burra
Subvencionimi nga njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjeve Gjinore (aplikueset Gra)	13	35	48	13	9	22	11,150€	8,850 €	20,000€	56%	44%	2. njera kryetare e komisionit	4
Subvencionimi individual- Bursat Studentore per vitin 2023. (nuk jane te përfshira burat e vazhduar sipas rregullores)	164	66	230	157	33	180	98,910€	20,790€	119,700€	86%	14%	2	4

Të dhënat në tabelë tregojnë një ndarje të dukshme gjinore në shpërndarjen e subvencioneve për vitin 2023. Për subvencionimin nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjeve Gjinore, aplikueset gra përbëjnë 35% të totalit, por përfitueset gra janë vetëm 9, duke marrë një total prej 8,850 € (44% e shumës totale), krahasuar me 20,000 € që shkojnë për burrat (56%). Ky rezultat sugjeron një pabarazi të theksuar në shpërndarjen e subvencioneve për gratë, ndonëse një grua është kryetare e komisionit. Ndërsa për bursat studentore, gratë përbëjnë 66% të aplikuesve, por vetëm 33% të përfituesve, duke marrë 20,790 € (14% e shumës totale), ndërkohë që burrat përfitojnë shumicën prej 119,700 € (86%). Këto rezultate tregojnë nevojën për përmirësim në mekanizmat e përzgjedhjes dhe ndihmën për gratë, duke i siguruar mundësi të barabarta për të përfituar nga mbështetjet financiare.

¹⁰ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Administratës Publike – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



2.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve¹¹

Mbështetje 01.01.-06, 2024	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve	
	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali Euro	OJQ Gra	Burra	Gra	Burra
Subvencionimi nga njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjeve Gjinore (aplikueset Gra)	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Subvencionimi individual- Bursat Studentore per vitin 2023. (nuk jane te përfshira burat e vazhduar sipas rregullores)	204	89	293	186	51	237	117,18 0.00€	32,13 0.00€	149,310.0 €	78.5 %	21.5%	2	4

Tabela tregon një shpërndarje të theksuar gjinore në mbështetjen financiare për programet e subvencionimit, ku gratë përfitojnë një pjesë të konsiderueshme të granteve, sidomos në bursat studentore për vitin 2023. Nga gjithsej 293 aplikues për bursat studentore, 204 janë gra (69.6%), ndërsa 89 janë burra (30.4%). Përfituesit janë gjithashtu të ndarë në përputhje me këtë shpërndarje, me 186 gra (78.5%) që përfitojnë bursat, ndërsa vetëm 51 burra (21.5%) përfitojnë. Shuma totale e granteve është 149,310.00 €, me një ndarje ku 117,180.00 € janë dedikuar për gratë dhe 32,130.00 € për burrat. Ky raport tregon një mbështetje të fortë për gratë në këtë program, duke reflektuar përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore, megjithatë, diferencat e theksuara mbeten në shpërndarjen e granteve mes grave dhe burrave.

¹¹ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Administratës Publike – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



2.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve, 2020/2021¹²

Viti	Lloji i Subvencionit	Gra	Burra
2020/2021	Subvencionim me bursa	80%	20%

Në vitin 2020/2021, të dhënat tregojnë një ndarje të theksuar gjinore në shpërndarjen e bursave. Gratë përbënin 80% të përfituesve të bursave, ndërsa burrat përbënin vetëm 20%. Kjo ndarje tregon një mbështetje më të madhe për gratë në këtë periudhë, duke reflektuar mundësinë e një angazhimi më të madh të grave në arsim dhe mundësi financiare për zhvillimin e tyre.

2.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve, 2023/2024¹³

Viti	Lloji i Subvencionit	Gra	Burra
2023/2024	Subvencionim për organizata	56%	44%
2023	Subvencionim me bursa	86%	14%
2024	Subvencionim me bursa	78.50%	21.50%

Të dhënat e vitit 2023/2024 tregojnë një ndarje të dukshme gjinore në shpërndarjen e subvencioneve. Për subvencionet për organizata, gratë përbëjnë 56% të përfituesve, ndërsa burrat 44%, duke reflektuar një shpërndarje më të barabartë mes gjinive. Ndërkohë, për subvencionet me bursa, gratë përfitojnë një pjesë të konsiderueshme të shumës, me 86% të përfituesve në vitin 2023 dhe 78.5% në vitin 2024, ndërsa burrat përbëjnë vetëm 14% dhe 21.5% përkatësisht. Kjo tregon një mbështetje më të madhe për gratë.

¹² Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Administratës Publike – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve

¹³ Po aty.



Takimi informues me Drejtorinë e Shëndetsisë së Mitrovicës së Jugut

Takimi u organizua më 16 janar 2024, në sallën e mediave të komunës së Mitrovicës. Pjesëmarrës në takim ishin gra të prekura nga kanceri, gra qytetare, gra nga shoqëria civile. 21 gra (17 shqiptare, një ashkalike dhe 3 boshnjake) dhe 2 burra shqiptarë.

Prezentimin për punën e drejtorisë së shëndetësisë e mbajti drejtori i drejtorisë, z.Berat Jashari., I cili fillimisht foli për drejtorinë dhe rolin e saj në shoqëri, lidhjen mes pacientëve dhe kushteve që mundohen t'i krijohen të sëmurëve, rikonstruktimin e ambulancave në lagje dhe fshatra, si dhe përgjegjësitë e mjekëve karshi qytetarëve pacientë.

“Zbatimi i buxhetimit gjinor është një problem në vetvete, pasi prioritet dhe kriter vendimtar në ndihmën financiare dhe mbështetje me medikamente është sëmundja e pacientit.”

-Drejtori I drejtorisë së Shëndetsisë në Komunën e Mitrovicës së Jugut Z. Berat Jashari

Në takim ishte një grua sapo e diagnostikuar me kancer, e cila iu drejtua shefit se si dhe ku duhet aplikuar për ndihmë. Përgjigja ishte: “Po, nëse i ke dokumentet me vete, eja në zyrë dhe menjëherë do t'i kryejmë procedurat e aplikimit.”

Diagnoza e sëmundjes dhe nevoja për përkrahje vendosin kriterin për mbështetje. Çdo herë diagnoza vendos përparësinë e mbështetjes, jo gjinia. Edhe pse kriteri përcaktohet në bazë të diagnozës dhe nevojës emergjente për përkrahje, sipas të dhënave, numri i grave përfituese është më i lartë. Por ndodh që grua të aplikojë për ndihmë në emër të fëmijës, por edhe ndonjëherë të burrit.

Rekomandimet

- Të rritet ndihma ose së paku dy herë në vit të subvencionohen gratë e sëmura nga kanceri.
- Medikamentet bazë (për gratë e prekura nga kanceri) të sigurohen së paku nga drejtoria përmes barnatores së QMKF.



3.1. Tabela e përfituesve të subvencioneve¹⁴

Mbështetje 01.01.-31.12.2023	Përfitues			Shuma			%	
	Gra	Burra	Total i	Gra	Burra	Totali Euro	Gra	Burra
2. Subvencionimi i personave fizik me qëllim të mbulimit të shpenzimeve mjekësore	<u>569</u>	<u>379</u>	<u>948</u>	<u>73,210€</u>	<u>52,780€</u>	<u>125,990€</u>	<u>58%</u>	<u>42%</u>

Në periudhën 01.01.-31.12.2023, mbështetja financiare për subvencionet e personave fizikë me qëllim të mbulimit të shpenzimeve mjekësore ka pasur një shpërndarje të ndryshme midis gjinive. Nga gjithsej 948 përfitues, 569 ishin gra dhe 379 burra. Shuma totale e subvencionit ishte 125,990 euro, ku gratë përfituan 73,210 euro (58% e totalit), ndërsa burrat morën 52,780 euro (42% e totalit). Ky rezultat tregon një mbështetje më të madhe për gratë, duke pasur parasysh se ato përbëjnë shumicën e përfituesve, por gjithashtu tregon një shpërndarje të drejtë të fondeve midis gjinive, përkundër se gratë janë të shumtë në këtë grup.

¹⁴ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Shëndetësisë – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Tabela 3.2 përfituesit e subvencioneve¹⁵

Mbështetje 01.01.-06, 2024	Përfitues			Shuma			%	
	Gra	Burra	Total i	Gra	Burra	Totali Euro	Gra	Burra
Subvencionimi i personave fizik me qëllim të mbulimit të shpenzimeve mjekësore	<u>400</u>	<u>179</u>	<u>221</u>	23,470.00 euro	19,530.00 euro	43,000.00 euro	65%	35%

Në periudhën 01.01.-06.2024, mbështetja financiare për subvencionet e personave fizikë me qëllim të mbulimit të shpenzimeve mjekësore është shpërndarë mes 400 përfituesve, nga të cilët 221 ishin gra dhe 179 burra. Shuma totale e subvencionit ishte 43,000 euro, me gratë që morën 23,470 euro (65% e totalit), ndërsa burrat morën 19,530 euro (35% e totalit). Këto rezultate tregojnë një mbështetje më të madhe për gratë, që reflekton një shpërndarje më të lartë të fondeve për to, duke ruajtur një diferencë të dukshme midis gjinive, e cila është më e theksuar se në vitin 2023.

¹⁵ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Shëndetësisë – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Tabela 3.3 përfituesit e subvencioneve 2020/2024¹⁶

Viti	Gra	Burra
2020/2021	80%	20%
2023	58%	42%
2024	65.10%	35%

Në periudhën 2020/2021, mbështetja financiare ka pasur një shpërndarje të theksuar në favor të grave, me 80% të përfituesve të grave dhe vetëm 20% të burrave, duke treguar një mbështetje shumë më të madhe për gratë. Megjithatë, në periudhën 2023-2024, të dhënat tregojnë një tendencë për të balancuar mbështetjen mes gjinive. Në vitin 2023, gratë përfituan 58% të mbështetjes, ndërsa burrat morën 42%, dhe në vitin 2024, mbështetja për gratë arriti në 65.10%, ndërsa burrat përfituan 35%. Ky ndryshim tregon një përafrim të mbështetjes për gratë dhe burrat, ku ende mbetet një përparësi për gratë, por përqindja është më e balancuar krahasuar me periudhën 2020/2021.

Rekomandimet

- Të rritet mbështetja për gratë dhe burrat e prekur nga kanceri, sëmundje me trajtim shumë të shtrenjtë

¹⁶ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Shëndetësisë – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Takimi u organizua më datë 07 mars 2024. Pjesëmarrës në takim ishin përfitues të skemave sociale, përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe qytetarë. Takimin e ndoqën 29 pjesëmarrës: 18 gra (12 shqiptare, 2 turke dhe 4 ashkallike) dhe 11 burra (9 shqiptarë dhe 2 ashkali).

Sipas drejtoreshës Drita Ibrahim, kjo drejtori përballet çdo ditë me sfida të ndryshme dhe, megjithë vështirësitë, përpiket t'u përgjigjet kërkesave të qytetarëve në nevojë. Në identifikimin e rasteve në nevojë ndihmojnë edhe kuvendaret e kuvendit, të cilat informojnë për raste që kanë nevojë për trajtim të veçantë.

“gratë prijnë në mbështetje, qoftë financiare apo ndihma me pako ushqimore.”

-Drejtoresha e drejtorisë së Mirëqenies Sociale në Mitrovicën e Jugut

Përveç ndihmës financiare për familjet dhe nënat vetushqyese, kjo drejtori ndihmon edhe familjet e pastrehë duke mbuluar pagesat e qirave (11 familje). Po ashtu, janë ndihmuar familjet që kanë pësuar dëme materiale gjatë vërshimeve në pranverën e vitit 2023 me pajisje shtëpiake. Kjo drejtori mbulon gjithashtu edhe shpenzimet e varrimeve të qytetarëve në bashkëpunim me Bashkësinë Islame.

Drejtoresha theksoi se është e vështirë të ndajmë përkrahjen mbi baza gjinore, pra të zbatojmë buxhetimin gjinor, pasi kemi të bëjmë me grupe në nevojë. Ajo gjithashtu shtoi se Mitrovica prin me numrin më të madh të qytetarëve që janë pjesë e skemës sociale në Kosovë.



Rekomandimet

- Vazhdimi i pagesave të qirave
- Vazhdimi dhe, mundësisht, rritja e ndihmave financiare.
- Mbështetje financiare për organizatat joqeveritare, përfshirë Handikos-in.

4.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve¹⁷

Mbështetje 01.01.-31.12.2023	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve	
	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali Euro	OJQ Gra	Burra	Gra	Burra
Subvencionimi i OJQ-ve që ndërlidhen me punën e DMS-së	<u>8</u>	<u>18</u>	<u>32</u>	<u>5</u>	<u>7</u>	<u>12</u>	<u>3,290.</u> <u>00€</u>	<u>10,630.</u> <u>00€</u>	<u>13,920.00</u> <u>€</u>	<u>38.47</u> <u>%</u>	<u>31.82</u> <u>%</u>	<u>1</u> <u>1</u>	<u>3</u> <u>4</u>

Tabela paraqet të dhënat për subvencionimin e organizatave joqeveritare (OJQ) të lidhura me punën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale (DMS) për periudhën 01.01.–31.12.2023. Gjatë këtij viti, janë regjistruar gjithsej 32 aplikime, prej të cilave 18 ishin nga gra dhe 8 nga organizata, ndërsa burrat paraqitën vetëm 6 aplikime. Përfituesit përfshinin 12 projekte, ku gratë përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme, me mbështetje financiare prej 10,630.00 €, ose 38.47% të totalit të granteve, ndërsa burrat përfituan 13,920.00 €, që përfaqëson 31.82% të totalit. Pavarësisht përpjekjeve për të përfshirë gratë, rezultatet tregojnë një disproporcion midis numrit të aplikuesve dhe përfituesve në aspekt gjinor, duke sugjeruar nevojën për politika më gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e fondeve.

¹⁷ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Mirëqenjes Sociale – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



4.2 Tabela e përfituesve të subvencioneve¹⁸

Mbështetje 01.01.-06, 2024	Përfitues			Shuma			%	
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali Euro	Gra	Burra
Subvencionimi i familjeve me qëllim të mbulimit të shpenzimeve në pagesën e qirasë.	<u>8</u>	<u>18</u>	<u>40</u>	<u>3,290.00€</u>	<u>7,340.00 €</u>	<u>10.630.00€</u>	<u>61.54%</u>	<u>66.67%</u>

Tabela përshkruan subvencionimin e familjeve për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për periudhën 01.01.–06.2024. Gjithsej janë ndihmuar 40 individ, ku 8 janë gra dhe 18 burra. Shuma totale e ndarë është 10,630.00 €, prej së cilës gratë kanë përfituar 3,290.00 € (61.54%), ndërsa burrat 7,340.00 € (66.67%). Megjithëse burrat përfaqësojnë pjesën më të madhe të përfituesve, vlera e përkrahjes për ta është më e lartë. Kjo tregon një mospërputhje të mundshme midis numrit të përfituesve dhe ndarjes së fondeve, duke sugjeruar nevojën për analizë më të thelluar për të siguruar barazi gjinore në mbështetje.

Krahasimi ndërmjet periudhës gusht 2020/korrik 2021 dhe shtator 2023/gusht 2024 nuk është i mundur, pasi gjatë periudhës gusht 2020/korrik 2021 kjo drejtori ka refuzuar të paraqesë tabela me të dhëna gjinore. Në periudhën 2023/2024, duke e pasur parasysh se nevojat dhe kërkesat si për gratë ashtu edhe për burrat janë të njëjta në raste sociale, sipas tabelave me të dhëna gjinore vërehet një dallim i vogël, rreth 5%, ndërmjet grave dhe burrave.

Rekomandimet

- Të krijohet një linjë buxhetore për dhunën me bazë gjinore, për të ofruar mbështetje financiare emergjente (veshmbathje, pajisje mjekësore, produkte higjienike) për gratë dhe fëmijët e prekur. Qendra “Raba Voca” të përfshihet gjithashtu në këtë linjë buxhetore.

¹⁸ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Mirëqenjes Sociale – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve



Takimi informues me Drejtorinë e Rinisë, Kulturës dhe Sportit së Mitrovicës së Jugut

Takimi u organizua më datë 15 prill 2024 Pjesëmarrës në takim ishin 23 persona: 18 gra dhe 11 burra shqiptarë, përfitues të granteve, përfaqësues të sportit, kulturës, organizatave joqeveritare dhe qytetarë.

Drejtorja e RKS përbëhet nga tri sektore, dhe ndarja e subvencioneve ndryshon nga sektori në sektor. Derisa sektori për rini dhe ai për kulturë subvencionojnë gratë dhe burrat me një dallim prej 10% deri në 20%, sektori i sportit ka një dallim jashtëzakonisht të lartë prej 90%. Në takim, ndër të tjera, u theksua se sporti i grave ende diskriminohet.

“Nuk ka klube të grave dhe ato nuk aplikojnë.”

z. Drejtori Fahri Jashari,
Drejtor i drejtorisë së
Rinisë, Kulturës dhe Sportit

“femrat në sport”

- burrat që mirren me sport dhe donatorët

“Klubi “Trepça” i futbollit për gra, që kryeson në vendin e parë brenda shtetit dhe ka depërtuar edhe në gara ndërkombëtare, ka 127 gra që stërviten atje, ndërsa në ekipin e parë luajnë dy gra të martuara. Klubi i volejbollit të grave gjithashtu mori pjesë në gara ndërkombëtare në vitin 2023, xhudistet janë shpërblyer me medalje, ndërsa edhe klubi i basketbollistëve ka pasur suksese të larta.

Rekomandimet

- Të përkrahen klubet e grave.
- Të promovohen klubet e grave në media dhe te sponsorët më shumë.
- Të rritet buxheti mbështetës për OJQ-të.
- Të ndërtohet një fushë sporti për klubin futbollistik të grave.
- Thirrjet publike për mbështetje të bëhen në fillim të vitit kalendarik



5.1 Tabela e përfituesve të subvencioneve¹⁹

Mbështetje 01.01.-31.12.2023	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve	
	OJQ Gra	OJQ Burra	Totali	OJQ Gra	OJQ Burra	OJQ Totali	OJQ Gra	OJQ Burra	OJQ Totali Euro	OJQ Gra	OJQ Burra	Gra	Burra
Subvencionimi nga Rinise, 2023	8	8	16	4	6	10	14,500 euro	18.500 Euro	33.000 euro	31%	69%	1	3

Në vitin 2023, subvencionimi i sektorit të Rinisë mbështeti gjithsej 16 përfitues, nga të cilët 8 ishin gra dhe 8 burra, me një ndarje totale të fondeve prej 33,000 euro. Nga kjo shumë, 14,500 euro ose 31% u shpërndanë për gra, ndërsa 18,500 euro ose 69% për burra. Kjo tregon një pabarazi të dukshme në shpërndarjen e fondeve, me burrat që përfitojnë një pjesë më të madhe të buxhetit të subvencioneve.

5.2 Tabela e përfituesve të subvencioneve²⁰

Mbështetje 01.01.-31.12.2023	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve	
1.	OJQ Gra	OJQ Burra	Totali	OJQ Gra	OJQ Burra	Totali	OJQ Gra	Burra	Totali Euro	OJQ Gra	Burra	Gra	Burra
Subvencionimi nga Sektori i Kultures	18	27	45	14	13	27	34,400 Euro	41,70 0 €	76,100,00€	56%	44%	1	4
3. Subvencionimi individual	4	3	7	4	3	7	2,900.00 €	2,000. 00 €	4,900,00€	55%	45%	1	2

¹⁹ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Rini, Kulturë dhe Sport – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve

²⁰ Po aty.



Gjatë periudhës 01.01.-31.12.2023, Sektori i Kulturës ka subvencionuar gjithsej 45 përfitues, nga të cilët 18 gra dhe 27 burra. Nga kjo, 27 përfitues ishin OJQ, me një ndarje fondesh prej 76,100 euro, ku 34,400 euro (56%) iu shpërndanë grave dhe 41,700 euro (44%) burrave, duke treguar një shpërndarje relativisht të balancuar të fondeve. Po ashtu, në subvencionimet individuale, u mbështetën 7 përfitues (4 gra dhe 3 burra) me një total prej 4,900 euro, nga të cilat 2,900 euro (55%) për gra dhe 2,000 euro (45%) për burra.

5.3 Tabela e përfituesve të subvencioneve²¹

Mbështetje 01.01.-31.12.2023	Aplikues			Përfitues			Shuma			%		Komisioni Vlerësues I granteve	
	Klube Gra	Klube Burra	Totali	Klube Gra	Klube Burra	Klube Totali	Klube Gra	Klube Burra	Klube Totali Euro	Klube Gra	Klube Burra	Gra	Burra
Subvencionimi nga Sektori i Sportit, 2023	6	46	52	4	42	46	32,500 Euro	237,800 Euro	270,300€	11%	89%	1	3

Tabela Krahasuese e Mbështetjes (2020/2021 dhe 2023)²²

Sektori	2020/2021 Gra (%)	2020/2021 Burra (%)	2023 Gra (%)	2023 Burra (%)
Rinia	27%	73%	31%	69%
Kultura	25%	75%	56%	44%
Sporti	4%	96%	25%	75%

²¹ Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria e Rini, Kulturë dhe Sport – Tabelat e të dhënave gjinore për përfituesit e subvencioneve

²² Po aty.



Krahasuar periudhat 2020/2021 dhe 2023, vërehet një përmirësim në mbështetje për gratë, veçanërisht në sektorët e rinisë dhe kulturës. Në sektorin e rinisë, mbështetja për gratë ka rënë vetëm pak, nga 27% në 31%, duke mbajtur një pabarazi mes grave dhe burrave. Sektori i kulturës ka pasur një ndryshim të madh, ku mbështetja për gratë është rritur në mënyrë të konsiderueshme, nga 25% në 56%, duke arritur një balancë më të mirë gjinore. Megjithatë, sektori i sportit mbetet shumë më i pabarabartë, edhe pse mbështetja për gratë është rritur nga 4% në 25%, burrat ende përfitojnë në masë të madhe nga fondet. Këto ndryshime sugjerojnë përparim, por tregon se sektori i sporteve ende ka nevojë për reforma më të thella për të siguruar mundësi të barabarta për të dyja gjinitë. Në gjashtë mujorin e vitit 2024 nuk ka pasur subvencione.

Rekomandimet

- Të sigurohet buxheti për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat për t'u angazhuar në sport.
- Të rriten subvencionet për 30% për klubet sportive të grave: klubin futbollistik “Trepça”, klubin e volejbollit “Trepça” dhe klubin basketbollistik “Trepça”.
- Drejtoria të angazhohet më shumë në promovimin e sportit të grave përmes mediave dhe tek donatorët.



Takimi informues me Zyrën e Punësimit së Mitrovicës së Jugut

Me datë 15 maj, 2024, u organizua takimi i gjashtë informues me Zyrën për Punësim të Komunës së Mitrovicës së Jugut. Takimin e ndoqën 18 pjesëmarrës: 11 gra dhe 7 burra shqiptarë (7 gra shqiptare, 4 gra ashkallike dhe rome, si dhe 6 burra shqiptarë dhe 1 ashkali).

Drejtori Besmir Salihu njoftoi të pranishmit se Agjencia për Punësim ka krijuar një program gjinor, “Programi i Vulës për Barazi Gjinore” për Institucionet Publike në Kosovë, roli i të cilit është forcimi i kapaciteteve dhe rezultateve të Agjencisë, duke iu përmbajtur ligjeve dhe politikave kombëtare për rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.

Gjithashtu, APRK ka krijuar një doracak “Barazia Gjinore për Punësim,” i cili ka për qëllim të mbështesë Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), përkatësisht Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional, që të përfshijnë perspektivën gjinore në punën e tyre, të zvogëlojnë qasjen e verbër gjinore, t’i thyejnë stereotipet dhe të kontribuojnë në barazinë gjinore përmes aktiviteteve të tyre.

Të dhënat më poshtë janë marrë nga Raporti Vjetor - Punësimi dhe Aftësimi Profesional 2023 – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

Punësimet e rregullta % Ndryshimi me 2022 SHP SHPS

Mitrovicë: 768 (21.7%) -27.1% 8.3% 31:1

Punësim i rregullt = 768 (21.7%)

Rajoni i Mitrovicës ka realizuar 21.7% ose 768 ndërmjetësime në punësim.

Shkalla e punësimit të rregullt sipas rajoneve - Mitrovica 8.3%



KONKLUZION

Duke iu referuar të dhënave të grumbulluara gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe Qarkores Buxhetore, shihet se Komuna e Mitrovicës zbaton në një masë buxhetimin gjinor, gjithmonë duke u bazuar në ligj, në nevoja, kërkesa emergjente dhe prioritet. Gjatë prezantimeve të drejtorëve në sesione informuese, nuk është vërejtur ndonjë angazhim i veçantë në zbatimin e buxhetimit gjinor, pra ndarjen e subvencioneve për gra dhe burra në barazi. Barazia gjinore është respektuar në raste kur vetë situata ka mundësuar ndarjen e subvencioneve, duke treguar një barazi midis grave dhe burrave. Të dhënat tregojnë gjithashtu një dallim shumë të lartë në favor të grave në rastin e bursave për vajza studente dhe një dallim shumë të lartë në ndarjen e subvencioneve në bujqësi në favor të burrave.

Gjatë realizimit të projektit është bërë një video përmbledhëse e takimeve të realizuara.²³

²³ [Shiko videon përmbledhëse e takimeve të realizuara.](#)

